

**CEFTA-Komuniteti i Transportit - Korsitë Blu (Blue Lanes) janë krijuar  
ndërmjet CEFTA-s dhe BE-së për të lehtësuar trafikun detar**

**Sistemi SEED për shkëmbimin elektronik të të dhënave është thelbi i nismës, i  
cili do të përshpejtojë procedurat doganore, formalitetet dhe kontrollet  
doganore**

*Romë, 9 Shtator 2022 – Nisma Korsitë Blu (Blue Lanes) do të përmirësojë  
trafikun detar midis Shqipërisë, Malit të Zi dhe Italisë, falë sistemit SEED+,  
Sistemi për Shkëmbimin Elektronik të të Dhënave, i cili është funksional në  
CEFTA.*

Z. Genti Gazheli, Drejtor i Përgjithshëm i Administratës Doganore të Shqipërisë,  
Z. Rade Millosheviq, Drejtor i Administratës së të Ardhurave dhe Doganave të  
Malit të Zi dhe z. Marcello Minenna, Drejtor i Agjencisë së Doganave, Akcizave  
dhe Monopoleve të Italisë, nënshkruan Memorandume Mirëkuptimi për  
shkëmbimin elektronik të të dhënave ndërmjet këtyre institucioneve në Romë.  
Kjo mundësi u shfrytëzua për të diskutuar mbi zhvillimin e ardhshëm të  
nismës Korsitë Blu (Blue Lanes) dhe marrëdhëniet tregtare në zonën e Detit  
Adriatik.

Ky është një moment historik i rëndësishëm për palët e CEFTA-s duke qenë se  
ky bashkëpunim do t'i shërbejë jo vetëm Shqipërisë dhe Malit të Zi, por edhe  
Palëve të tjera të CEFTA-s që do të përdorin portet në Shqipëri dhe Mal të Zi  
për tregti. Krijimi i infrastrukturës së TI-së është në vazhdim dhe pritet që  
sistemi të funksionojë në vjeshtën e vitit 2022. **Ky bashkëpunim hap  
mundësitë për zgjerimin e mëtejshëm të nismave të Korsive të Gjelbërta dhe  
Blu drejt vendeve të tjera anëtare të BE-së.**

Të dhënat do të shkëmbehen elektronikisht përmes platformës SEED,  
financuar nga BE. Sistemi SEED për shkëmbimin elektronik të të dhënave ka një  
rol vendimtar në zbatimin e Korsive të Gjelbërta CEFTA-TCT në CEFTA, por  
edhe ndërmjet CEFTA-s dhe Greqisë, që ka funksionuar që nga korriku i këtij  
viti.

SEED është implementuar që nga viti 2010, më vonë është përmirësuar në SEED+ dhe ka **përmirësuar menaxhimin e pikave të kalimit** në Ballkanin Perëndimor, **ka përmirësuar efikasitetin** dhe komunikimet ndërkufitare si dhe procedurat e thjeshtuara dhe të modernizuara.

“Sistemi SEED është thelbi i iniciativave të Gjelbërta/Blu, duke ofruar infrastrukturën e sigurt të TI-së për përshpejtimin e procedurave doganore, formaliteteve dhe kontrolleve doganore, jo vetëm ndërmjet Palëve të CEFTA-s, por edhe me BE-në. Duke qenë shumë fleksibël dhe i adaptueshëm, sistemi SEED po i afron administratat dhe bizneset tona më pranë BE-së dhe tregut të saj të përbashkët - deklaroi z. Emir Djikic, drejtor i Sekretariatit të CEFTA-s.

Memorandumet e nënshkuara midis Shqipërisë, Malit të Zi dhe Italisë mbajnë në konsideratë plotësisht rëndësinë e detyrimeve doganore dhe taksave të tjera të aplikueshme gjatë tregtisë së mallrave, njeh nevojën për bashkëpunim ndërkufitar dhe merr parasysh objektivat e Planit të Veprimit të Përbashkët Rajonal të Tregut.

Krijimi i Korsive të Gjelbërta CEFTA-TCT brenda Ballkanit Perëndimor gjatë COVID-19 rezultoi të ishte një nga shembujt më të suksesshëm të bashkëpunimit rajonal.